



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 760, Datë 14.01.2021**

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2021, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.

**Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.

**VËREN SE :**

**Transaksioni dhe përqendrimi**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfimin e kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.

Sipas Marrëveshjes Kuadër nënshkruar më datë 23 nëntor 2020 palët në transaksion janë:

**Pala Blerëse:** Unione di Banche Italiane SPA është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas legjislacionin Italian. Aktiviteti i saj fokusohet veçanërisht tek menaxhimi i portofolit të klientëve individë.

Unione di Banche Italiane SPA zotërohet 100% nga shoqëria Intesa Sanpaolo SPA, shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare kryesore italiane.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania ShA

**Target:** Aviva Vita SPA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë, e cila operon si një shoqëri sigurimi, ekskluzivisht në shtetin italian.

### **Pala Shitëse:**

Shitësi 1: Aviva Italia Holding SPA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë. Objekti i shoqërisë është ofrimi i sigurimeve të kredisë, mbrojtje investimesh, bono dhe politika të sigurimit të jetës.

Shitësi 2: Aviva Italia SPA është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë. Objekti i shoqërisë është ofrimi i sigurimeve të kredisë, mbrojtje investimesh, bono dhe shërbime të tjera sigurimi, risigurime dhe menaxhim fondesh etj.

### **Analiza e konkurrencës**

Mbështetur mbi dokumentacionin e depozituar, transaksioni i njoftuar plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 dhe 12, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkon autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i sigurimeve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë Aviva Vita S.p.A nga shoqëria Unione di Banche Italiane S.p.A. Unione di Banche Italiane S.p.A pas transaksionit do të marrë kontrollin e plotë të shoqërisë Aviva Vita S.p.A e cila është aktive në tregun e sigurimeve të jetës ekskluzivisht në Itali.

Aviva Vita S.p.A nuk është prezent në tregun shqiptar dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Unione di Banche Italiane S.p.A. realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar nga Grupi Intesa Sanpaolo, bankës Intesa Sanpaolo Albania SHA, e cila është aktive në tregun e shërbimeve bankare.

Përqendrimi i njoftuar realizohet mes palëve që operojnë në tregje të ndryshme duke mos krijuar mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të tyre në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë efekt në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

## **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Aviva Vita SPA nga shoqëria Unione di Banche Italiane SPA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**